



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

Data: 16.09.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE APARATURË LABORATORIKE PËR
LABORATORIN QËNDROR TË ISHTI-it”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) 38000000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 24,933,332.3 (njëzetë e katër milion e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy pikë tre) lekë pa TVSH ose **251,015.12** (dyqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëmbëdhjetë pikë dymbëdhjetë) Euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 16.09.2024 është 99.33)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për

Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar,; nenin 43 pika 2/a dhe nenin 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6 /337 Tirane (në krah të Gjykatës së Lartë)– www.obp.al

mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin emnistrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore

të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për mallin objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: *Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Organi qëndror blerës, i cili kryen procedurën e prokurimit për llogari të Autoritetit Kontraktor përfitues ISHTI, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues për mallin që ata ofrojnë. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale për mallra sa më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për këtë pajisje është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent.*

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qellim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike nga prodhuesi/distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallin objekt prokurimi, ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallit që do të ofrohet, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / skedës teknike nga prodhuesi/distributori i autorizuar nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë AK - Organit Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues për llogari të të cilit Organi Qëndror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike nga prodhuesi/distributori i autorizuar nga prodhuesi siguron disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se pajisja e ofertuar është sipas normave të Konformitetit EC/Certifikatat CE ose ekuivalente e saj. Gjithashtu operatori fitues duhet të shoqërojë pajisjen me Deklaratën e Konformitetit EC / Certifikatat CE ose ekuivalente e saj, që vërteton të dhënat teknike, standartin e prodhimit sipas kërkesave mbi standartin e përcaktuar në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, neneve 8, 9, 10, 11 dhe 12 i ligjit nr. 10489 date 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore", nenin 40 pika 8 dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Deklarata nga operatori ekonomik se pajisja e ofertuar është sipas normave të Konformitetit EC/Certifikatat CE ose ekuivalente e saj dhe në momentin e dorëzimit të pajisjes në Autoritetin Kontraktor përfitues pajisja të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit EC / Certifikatat CE ose ekuivalente e saj, kërkohet për të demonstruar përmbushjen e kërkesave për të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj produktit, përfshirë dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për instalimin/ kalibrimin dhe trajnimin e stafit të Autoriteti Kontraktor përfitues, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën Nr. 5, duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi ose nga autoritete të autorizuar/ certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për formimin profesional për të lëshuar certifikata/dëshmi trajnimi/kualifikimi për pajisjen objekt prokurimi ose ekuivalente.

Për specialistin e kërkuar duhet të paraqesë dokumentet:

Kontratë pune/kontratë bashkëpunimi, të vlefshme.

Çertifikatë/dëshmi, sipas fushës përkatëse të përcaktuara më sipër (origjinale ose fotokopje të noterizuar)

Shenim: Kriteri nr.2.3.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se operatori ekonomik ka në dispozicion staf të kualifikuar për realizimin e objektit të prokurimit. Duke qënë se malli objekt prokurimi është pajisje laboratorike specifike, Aparat për përcaktimin e llojeve të hidrokarbureve dhe oksigjenit në benzinën e automjeteve dhe në etanol (E85) si karburant i automjeteve, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë në dispozicion një specialist të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës sipas objektit. Specialisti i kërkuar është i nevojshëm për instalimin dhe kalibrimin, për vënien në punë brenda parametrave optimalë për të funksionuar sic duhe pajisja e kërkuar, me qëllim përmbushjen e të gjitha funksionaliteteve të saj. Specialisti në dispozicion të operatorit ekonomik mund të jetë i certifikuar nga prodhuesi ose nga autoritete të autorizuar/ certifikuar për lëshuar certifikata/dëshmi trajnimi/kualifikimi për pajisjen objekt prokurimi ose ekuivalente, kjo me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Kërkesa që specialisti i certifikuar/kualifikuar i operatorit ekonomik, të bëjë edhe trajnimin e stafit të AK përfitues është vendosur për të siguruar që përdoruesit të dinë se si të përdorin pajisjen në mënyrë të sigurt duke minimizuar rrezikun e aksidenteve apo dëmtimeve lidhur me këtë pajisje. Përdoruesit e trajnuar do të jenë më të aftë të përdorin pajisjen në mënyrë efikase duke përmirësuar produktivitetin dhe*

cilësinë e rezultateve të matjeve. Gjithashtu njohuritë e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes ndihmojnë në jetëgjatësinë e kësaj pajisje.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësin është i nevojshëm për të provuar që është i pajisur me certifikate/çdo dokument tjetër që të vërtetojë trajnimin/kualifikimin për pajisje Aparat për përcaktimin e llojeve të hidrokarbureve dhe oksigjenit në benzinën e automjeteve dhe në etanol (E85) si karburant i automjeteve, ose ekuivalente.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatat ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, sipas objektit të prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar nën 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të certifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

ISO 9001:2015 - *Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. ISO 9001:2015, sipas objektit të prokurimit, specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:*

- duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.*
- synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.*

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj certifikate të 9001: 2015 ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se OE ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se garancia e pajisjes dhe të gjithë aksesorëve do të jetë 12 muaj nga momenti i instalimit dhe kalibrimit të aparaturës pranë Autoritetit Kontraktor përfitues, periudhë gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë të defekteve që mund të vijnë nga prodhimi. Artikulli objekt prokurimi duhet të shoqërohet më fletë garancie në momentin e dorëzimit të tij pranë Autoritetit Kontraktor përfitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallin që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit apo instalimit/kalibrimit të tij.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër transportin, instalimin e kalibrimin e pajisjes laboratorike dhe se pas instalimit dhe kalibrimit të pajisjes, do të lëshojë certifikatë kalibrimi të pajisjes laboratorike dhe certifikata trajnimi për personelin e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Gjithashtu, operatori ekonomik, duhet të marrë përsipër edhe instalimin dhe kalibrimin e pajisjes laboratorike, objekt prokurimi, brenda parametrave optimalë për të funksionuar siç duhet, në përmbushjen e funksionalitetit të tij dhe përmbushjes korrekte të qëllimit për të cilin kërkohet kjo pajisje dhe për këtë operatori ekonomik do të lëshojë certifikatë kalibrimi të pajisjes, duke siguruar Autoritetin Kontraktor se pajisja është në funksion të plotë dhe sipas rregullave. Referuar edhe përcaktimeve të bëra në specifikimet teknike është cilësuar edhe kërkesa për kryerjen e trajnimit për përdoruesit e kësaj pajisje, pjesë e stafit të Autoritetit kontraktor përfitues. Qëllimi i vendosjes së deklaratës përpos të tjerave edhe i kërkesës për trajnimin dhe lëshimin e certifikatave të trajnimit, është vendosur për të siguruar që përdoruesit të dinë se si të përdorin pajisjen në mënyrë të sigurt duke minimizuar rrezikun e aksidenteve apo dëmtimeve lidhur me këtë pajisje. Përdoruesit e trajnuar do të jenë më të aftë të përdorin pajisjen në mënyrë efektive duke përmirësuar produktivitetin dhe cilësinë e rezultateve të matjeve. Gjithashtu njohuritë e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes ndihmojnë në jetëgjatësinë e kësaj pajisje.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike janë struktura të specializuara/ Grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

1. Aparat për përcaktimin e llojeve të hidrokarbureve dhe oksigjenit në benzinën e automjeteve dhe në etanol (E85) si karburant i automjeteve.

- Aparati duhet të zbatojë metodën standarde S SH EN ISO 22854:2021;
- Aparati duhet të jetë gazkromatograf multidimensional;
- Aparati duhet të përcaktojë përmbajtjen e hidrokarboneve aromatike dhe olefinik, të saturuarave, benzenit, toluenit, komponimeve të oksigjenuara dhe oksigjenin total tek benzina për automjete dhe etanolin që përdoret për mjetet motorrike (E85);
- Sistemi duhet të japë konfigurim të përmbajtjes së parafinave, olefinave, nafteneve, aromatikeve, benzenit, komponimeve të oksigjenuara, përmbajtjes së oksigjenit dhe të komponimeve të saturuara të shprehura në % masë (m/m) dhe volum (V/V);
- Aparati duhet të përllogarisë dhe densitetin e këtyre komponentëve (në g/ml dhe kg/m³);
- Aparati duhet të përllogarisë vlerën e RON dhe MON;
- Aparati duhet të përllogarisë raportin e elementëve organikë C:H:O;
- Aparati duhet të punojë i lidhur me një gaz të llojit helium ose azot me pastërti 99,99%. (Gazi hidrogjen nuk preferohet për arsye të rrezikshmërisë së lartë të eksplozionit;
- Aparati duhet të jetë prodhim i ri, jo më herët se 3 (tre) vitet e fundit;
- Aparati duhet të jetë i pajisur me “autosampler” të paktën me 15 vende (dhomëza);
- Aparati duhet të jetë i shoqëruar me një sistem kompjuterik të kompletuar si: monitor, printer, infrastrukturë për lidhje rrjeti, sistem operimi dhe aplikues softueri;
- Të jetë i shoqëruar nga një set materialesh reference (CRM dhe standarde për kalibrimin e pajisjes) dhe me aksesoret e pjesët e këmbimit;
- Instalimi dhe kalibrimi i pajisjes, si dhe trajnimi i personelit të AK, të kryhet nga një trup e certifikuar.
- Pas kalibrimit të pajisjes, personeli teknik i kualifikuar për instalim, kalibrim dhe trajnim duhet të lëshojë certifikata kalibrimi dhe certifikata trajnimi (të njohura) për personelin;
- Garancia e pajisjes dhe të gjithë aksesoretë të jetë 12 muaj nga momenti i instalimit dhe kalibrimit të aparaturës;
- Të jetë i pajisur me manual përdorimi nga firma prodhuese;

- Të jetë i shoqëruar me një metodë të shkurtër të përshkrimit të punës te përkthyer në gjuhën shqipe.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Sa më sipër, specifikimet teknike dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët e fushës së Autoritetit Kontraktor përfitues. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Specifikimet teknike*

NJËSIA E PROKURIMIT